

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
“WIPROTECTION”**

**S T A T U T**

**I**

**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“WIPROTECTION”**

**Tiranë, prill 2021**

**S T A T U T**

**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“WIPROTECTION”**

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “**WIPROTECTION**”, sot me datë 08. prill 2021 (dymijë e njëzetënëjë), bazuar ne aktet ligjore në fuqi, si dhe në ligjin nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, vendosi themelin e shoqërisë “**WIPROTECTION**” sh.p.k.

**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

## Neni 1 Ortaket

Themeluesi i shoqërisë është:

Z. **Ndriçim Ibro**, i biri i Arshiut, i datëlindjes 07.09.1966, lindur në Skrapar e banues në Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 2, Rruga “Arkitekt Kasemi”, Nr. 25, identifikuar me ID me nr. personal G60907064K, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Cel. + 0696439047,

i cili, ka vendosur krijimin e shoqërisë “**WIPROTECTION**” sh.p.k. aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni Shqiptar.

Shoqerija fillon aktivitetin me themeluesin e saj si ortak i vetëm.

Ky status parashikon edhe rregullimin e mardhenjeve ne rastin e pjesëmarrjes te ortakeve ne një moment te dyte duke i përshkruar si me posht.

## Neni 2 Objekti

2.1 Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm:

- a. Ofrim të shërbimeve në funksion të sigurimit dhe mbrojtjes të integritetit individual, familjar apo institucional. Mbrotje nga rreziqet fizike, cenimit të privacisë, rrjedhjes së informacioneve. Grumbullim provash të vërtetësisë apo pavërtetësisë si dhe ekspertizat përkatëse për klientin. Trajnim apo edukim të specialistëve në këtë fushë.
- b. Import dhe tregtim brenda e jashtë vendit të teknologjisë (kamerave të vëzhgimit, aparate fotografike dhe pajisje të tjera digjitale) në funksion të sigurisë fizike, integritetit individual, privacisë, të individëve, entiteteve private apo publike.
- c. Import dhe tregtim të pajisjeve e softwarëve që sigurojnë mbrotje kibernetike për informacione, data base e të dhëna personale, të individëve, entiteteve private apo publike.
- d. Instalim teknologje moderne për sigurimin objekteve të rëndësisë të veçantë. Ofrimi i shërbimit të “dezinfektimit elektronik” të ambienteve.
- e. Blerje të shërbimeve në fushën e sigurisë, brenda dhe jashtë vendit, me qëllim rishitjen apo mbulim të nevojave të klientetëve.
- f. Ofrim shërbimesh nëpërmjet ekzaminimeve e testimeve në fushat e traseologjisë, daktiloskopisë, balistikës, kimisë, biologjisë, ekzaminimit të dokumenteve, fotografisë, kibernetike/digjitale, në funksion të çështjeve penale, civile, administrative, etj., duke përdorur metoda, teknika dhe procedura shkencore.
- g. Kryerja e detyrave të detektivit apo gjurmuesit privat duke hetuar fakte dhe rrethana në funksion të çështjeve penale, civile, administrative, etj., apo sipas kërkesës nga individë apo subjekteve publike e private, duke zbatuar procedurat përkatëse.

- h. Ofrimi shërbimeve në verifikimin e besueshmërisë dhe pastërtisë të burimeve njerëzore, evidentimi i rasteve të mashtrimit të brendshëm, keqprezantimit, konfliktit të interesit apo rasteve që kanë ndikim në aktivitetin entiteteve private apo publike.
  - i. Ofrimi i shërbimeve të shoqërimit, ruajtjes, mbrojtjes dhe sigurimit (eskortë) të individëve e personaliteteve apo mjeteve, objekteve e rezidencave e të tyre nga shoqëria vetë apo nëpërmjet kontraktimit të tretëve.
  - j. Ofrimi i shërbimeve fushën e arsimit, kualifikimit dhe formimit profesional nëpërmjet programeve që kombinojnë arsimin me praktikën profesionale, duke pajisur individët me njohuri e shprehi të veçanta, si dhe me kompetenca të gjera që kërkohen për t'u punësuar në një profesion të caktuar për t'u integruar në tregun e punës në përfundim të cilat certifikon njohuritë, aftësitë dhe vlerat nëpërmjet një dokumenti përkatës (certifikatë).
  - k. Kryerja e detyrave të ndërmjetësit, negociatorit e këshilluesit financiar. Verifikimi i transparencës në transaksione për individë, manaxherë të fondeve të pensioneve, bankat, kompanitë e sigurimit dhe institucionë të tjera.
  - l. Mbështetje dhe këshillim ligjor, nëpërmjet informacionit, analizës dhe aftësive për të ndihmuar klientët në përmbushjen e interesave të tyre. Bashkëpunimi me ekipet ligjore, duke siguruar materiale për fusha specifike. Nërmjetësimi në trajtimin dhe zgjidhjen e konflikteve.
  - m. Hulumtimi ose auditimi në rastet e një investimi të mundshëm për të verifikuar informacionet që ofron pala tjeter para se të lidhet një marrëveshje apo kontratë për të evituar rrisjet e mundshme, duke marrë parasysh aspektet ligjore, financiare, të marketingut, teknike, etj.
  - n. Verifikimi i kontraktorëve të mundshëm e personelit të tyre gjatë fazës së negociatave duke vlerësuar risqet që mund të cenojnë kontratën apo marrëveshjen dhe prodhimi i raporteve të pajtueshmërisë/përputhshmërisë.
  - o. Marrja me qira të hapësirave për publicitet/marketing, organizim kursesh, konferencash, trajnimesh në fushat e mësipërme.
  - p. Përfaqësimi i kompanive apo shoqërive të ndryshme shqiptare dhe të huaja që kanë objekt të njëjtë apo të përafërt me atë të shoqërisë.
  - q. Kryerja e çdo veprimtarie tjeter që parashikon legjislacioni shqiptar në funksion të objektit të aktivitetit të shoqërisë.
- 2.2 Shoqëria mund të përfshihet në ngritjen, administrimin e pikave të ushtrimit të aktiviteteve të mësipërme dhe të tregëtimit të produkteve të mësipërme, zhvillimin e rrjeteve të brendëshme e të jashtme prodhim, shitje, eksport, import, shërbime administrative, shërbime marketingu e promovuese në fushat e mësipërme.
- 2.3 Veprimtaritë e mësipërme kontribojnë kryesisht në:
- a. zhvillimin e biznesit shqiptar në fushën objekt i aktivitetit të shoqërisë,
  - b. zhvillimin, lehtësim dhe përshtatshmërinë me tregun Evropian e botëror,
  - c. zhvillimin e tregut në fushën e sigurisë kibernetike,
  - d. futjen e kapitaleve të huaja dhe ndërmjetësimi për financime në Shqipëri,
  - e. nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve shqiptare dhe ato të Komunitetit Evropian e

ato të vendeve të tjera të botës.

- 2.4 Për kryerien e veprimtarisë së saj Shoqëria do të bashkëpunojë e lidhë marrëveshje me persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj.
- 2.5 Shoqëria mund të kryejë çdo operacion finansiar, tregtar, shërbimi, industrial, me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme, që mund të lidhen me një nga objektet e sipërpërmendura.

**Neni 3**  
**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pa përcaktuar.

**Neni 4**  
**Selia**

- 4.1 Selia e Shoqërisë si dhe adresa e saj ligjore do të jetë në Tiranë, Shqipëri, në adresën provizore: Rruga Kombëtare Tiranë-Elbasan, Komuna Kërrabë, Fshati Mushqeta, Zona Kadastrale 2752, Nr. 110/3, Tiranë.
- 4.2 Me vendim të ortakëve mund të hapen zyra, filiale, shërbime dhe agjenci në të gjithë territorin e Shqipërise si dhe jashtë territorit të Shqiperisë, me vendim miratues të Asamblesë së Ortakëve.

**KREU II**  
**KAPITALI**

**Neni 5**  
**Kapitali themeltar**

- 5.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10.000 (dhjetëmijë) Lekë e ndarë në 1 (një) kuot. Vlera e 1 (një) kuote është 100 (njëqind) Lekë.
- 5.2 Pjesëmarra e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij si më poshtë:

Ortaku themelues:

Z. Ndriçim Arshi Ibro, i datëlindjes 07.09.1966, Zotërues i kuotës me vlerë të përgjithshme që përbën 10.000 (dhjetëmijë) Lekë e barabartë me 100 (njëqind) % (përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

- 5.3 Përgjegjësia e Ortakëve ndaj të tretëve, për detyrimet e Shoqërisë, kufizohet në masën e pjesëmarjes së tyre në Kapitalin Themeltar.

**Neni 6**  
**Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

- 6.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
- 6.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 6.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
- 6.4 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

### **Neni 7 Transferimi i kapitalit**

- 7.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a.kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b.shit-blerjes;
  - c.trashëgimisë;
  - d.dhurimit;
  - e.çdo mënyrë tjeter të parashikuar me ligj.
- 7.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 7.3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **KREU III ORGANET E SHOQËRISË**

### **Neni 8 Organi Vendimmarrës**

- 8.1 Asambleja e Ortakëve eshte organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 8.2 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të Statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 8.3 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b. ndryshimet e statutit;
  - c. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - ç. emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendor në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
  - dh. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e

- pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f. pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - gj. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 8.3 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje që përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

### **Neni 9**

#### **Mënyra e thirrjes se mbledhjes**

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përparrë datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.
- 9.2 Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### **Neni 10**

#### **Kuorumi**

- 10.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- 10.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 88, të këtij ligji.
- 10.3 Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

### **Neni 11**

#### **Marrja e vendimeve**

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruarve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e Statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 11.2 Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si:
- përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - përcaktimin e shpërblimeve;
  - mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimitarisë;
  - përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë.
- 11.3 Çdo ndryshim Statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

### **Neni 12 E drejta e votës**

- 12.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, çdo kuotë jep të drejtën e një vote.
- 12.2 Statuti mund të parashikojë për ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e Asamblesë me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.
- 12.3 Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:
- transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;
  - komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjeter;
  - mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpala apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së Asamblesë, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.
- 12.4 Përdorimi i mjetave elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.
- 12.5 Ortakët kanë të drejtën, që u njihet nga ky ligj apo statuti, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

### **Neni 13 Përjashtimi nga e drejta e votës**

13.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për:

- a. vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b. shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c. ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d. dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

13.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesit, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### **Neni 14** **Administrimi**

14.1 **Z.** Ndriçim Ibro, i biri i Arshiut, i datëlindjes 07.09.1966, lindur në Skrapar e banues në Tiranë, me letërnjoftim me nr. personal G60907064K, emërohet si Administrator i parë i shoqërisë për një periudhë 5 vjecare.

14.2 Administratori ka të gjitha kompetencat e nevojshme për kryerjen e procedurave të regjistrimit të shoqërisë sipas legjisacionit në fuqi.

14.3 Administratori mund tu delegojë të tretëve, personave fizik ose juridik, për kryerjen e regjistrimit pranë enteve shtetërore, si dhe hapjen e llogarisë së shoqërisë pranë një banke të nivelit të dytë për llogari të shoqërisë.

### **Neni 15** **Kompetencat e Administratorit**

15.1 Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a. kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b. përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve e të librave kontabël të shoqërisë;
- ç. përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- d. krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh. kryejë regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Bisnesit;
- e. raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë. kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në Statut.

15.2 Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Pergjithshme, në rastet kur:

- a. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- b. shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- c. shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

15.3 Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **Neni 16**

### **Përgjegjësitë e Administratorit**

16.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per tregtarët dhe shoqërite sregtare“, administratori detyrohet të:

- a. kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;
- b. ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në Statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c. vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- d. parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- e. ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

16.2 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

16.3 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja

është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

- 16.4 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:
- u kthen ortakëve kontributet;
  - u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - lejon qëshoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për tëshlyer detyrimet;
  - jep kredi.
- 16.5 Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që ingarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të demit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financiar, nëse është e nevojshme.
- 16.6 Asnjë vendim i Asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë-padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

### **Neni 17 Bordi Këshillues**

- 17.1 Bordi Këshillues është organizëm i cili ndihmon administratorin e shoqërisë dhe ka si mision dhe detyrë të ndihmojë në marrjen e vendimeve strategjike, ndjekjen dhe zhvillimin e projekteve.
- 17.2 Çdo anëtar i Bordit Këshillues duhet të ketë mundësinë që të ofrojë opinione, këshilla dhe konsulencë për arritjen e objektivave të Shoqërisë.
- 17.3 Bordi Këshillues përbëhet nga individë të cilët kanë një eksperiencë të gjatë në veprimitari të cilat janë të lidhura me objektin e veprimitarisë së Shoqërisë apo individë që kanë një ekspertizë të lartë në një nga këto fusha.
- 17.4 Anëtarëve të Bordit Këshillues nuk i ofrohet kompensim financiar dhe angazhohen si të tillë pro bono.
- 17.5 Bordi Këshillues komunikon me Administratorin apo anëtarët e Shoqërisë nëpërmjet kanaleve të dedikuara të komunikimit (mailing list, IRC/chat etj);

### **Neni 18 Detyrat e Bordit Këshillues**

- 18.1 Shqyrton dhe jep mendim për projektet strategjike të Shoqërisë.
- 18.2 Ndihmon administratorin në vendimmarrjen sipas kompetencave dhe detyrave.
- 18.3 Ndihmon dhe mbështet administratorin për zbatimin e politikave dhe realizimin e objektivave e detyrave të shoqërisë.

- 18.4 Asiston Administratorin në përbushjen e realizimin e objektivave vjetore të shoqërisë.
- 18.5 Parashton mendime dhe opinioneë për çështje të ndryshme që janë brenda objektit të aktivitetit të shoqërisë.
- 18.6 Bën prognoza dhe për dukuri e fenomene që kanë të bëjnë me të ardhmen e Shoqërisë.
- 18.7 Anëtarët e Bordit Këshillues duhet të ruajnë konfidentialitetin e veprimtarisë së tyre për çështje sensitive që kanë të bëjnë me veprimtarinë e shoqërisë.

## **KREU IV** **VITI FINANCIAR, EKSPERTËT**

### **Neni 19** **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 janar dhe perfundon më 31 dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finansiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Bisnesit (QKB) dhe mbyllet me 31 dhjetor.

### **Neni 20** **Ekspertët**

- 20.1 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtar të shoqerise, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.
- 20.2 Eksperti kontabël i autorizuar në përfundim të kontrollit përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor, si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

## **KREU V** **PRISHJA, RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

### **Neni 21** **Prishja dhe likuidimi**

- 21.1 Shpërndarja ose prishja e Shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:
- kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
  - me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
  - me hapjen e procedurave të falimentimit;

- d. nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me pikën 3, të nenit 43, të ligjit nr. 9723, datë 3.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
  - e. me vendim të gjykatës;
- 21.2 Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të Shoqërisë, duke caktuar 1 (një) apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".
- 21.3 Prishja e shoqërisë tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët. Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

### **Neni 22 Regjistrimi i shpërbërjes**

- 22.1 Administratorët regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".
- 22.2 Nëse prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Regjistrimeve për regjistrim.

### **Neni 23 Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet apo bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX, të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

### **Neni 24 Baza Ligjore**

- 24.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 24.2 Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil të RSH dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 25**

## **Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

### **Neni 26**

Ky statut, është hartuar në 4 (katër) kopje, në gjuhën Shqipe.

### **ORTAKU I VETËM**

### **NDRIÇIM IBRO**

(Ndriçim Ibri) 